



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E TURIZMIT, KULTURËS DHE SPORTIT
KËSHILLI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE MATERIALE

Nr. 644 Prot.

Tiranë, më datë 20.11.2025

VENDIM
Nr. 581, datë 20.11.2025

Në mbështetje të Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, neni 38, pika 2, V.K.M Nr. 208, datë 10.04.2019 “Për Përbërjen, Mënyrën e funksionimit, Kompetencat dhe Shpërblimin e Anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale”, Urdhërit Nr. 223, datë 03.07.2020 “Për miratimin e rregullores për veprimtarinë e Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale, Këshillit Teknik, Sekretarisë Teknike dhe Sportelit Unik të Saj”, pas shqyrtimit më parë të projektit në Këshillin Teknik, Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale, në mbledhjen e datës 20.11.2025:

VENDOSI

1. Shtyrjen e vendimmarrjes për Raportin e vëzhgimit arkeologjik sipërfaqësor hartuar në kuadër të projektit “Resort multifunksional, banim, hotel dhe shërbime me 2, 3, 4, 5 kate mbិតokë dhe 1-2 kate nëntokë, faza I”, me vendndodhje në Bashkinë Sarandë, me zhvillues subjekti “**TDT & Partners**” sh.p.k., me argumentin:
 - Të hartohet koncept për sondazhe arkeologjike nga individ i licencuar në arkeologji në hapësirën Brenda Zonës arkeologjike “B” të Kalasë së Lëkursit dhe më pas të paraqiten për shqyrtim dhe vendimmarrje në KKTKM;
2. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi;
3. Kundër këtij vendimi mund të ushtrohet ankimi në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni. Ankimi nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETAR
Kiara XHELILI

